

Dr. Sedat Islami

Menjëherë pas sulmit të mbrëmshëm në Nice të Francës, politikanë, analistë, opinionitë e gazetarë, publikuan deklaratat ku dënonin terrorizmin.

Disa në reagimet e tyre nuk kurseheshin nga përshkrimi i rastit si terror fetar. Madje, bënë thirrje ekstremiste duke:

- përshkruar Islamin si fe e terrorit në tërësi
- duke fyer Profetin [Paqja dhe lëvdatat qofshin mbi të]
- duke bërë thirrje për të na ndarë në NE dhe ATA

Nuk kaluan as njëzet e katër orë dhe ja del në shesh identiteti i vërtetë fetar i terroristit:

"Flet kushëriri i gruas së sulmuesit të Nices: Ai nuk ishte mysliman, kurrë s'ka shkuar në xhami dhe e ka rrahur gruan"

"Në dosjen e tij ka dëshmi për vjedhje e krime..."

Sigurisht, këto veprime, sikur edhe ky i fundit, nuk kanë lidhje me Islamin, andaj, me shqetësim po e parashtoj këtë pyetje:

Nga e keni këtë guxim që të na terrorizoni?

A mbani përgjegjësi për fjalët dhe sjelljet tuaja ekstreme?

Kam besimin dhe bindjen e thellë se një ditë Islami do të triumfojë mbi akuzat ndërsa ju, terroristë, çfarëdo qofshit, do të përgjigjeni para ligjit!